VENDIM
Nr. 559, datë 18.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 656, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET SANITARE NË ORIKUM""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 656, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për tokë "pemishte", "ullishte" dhe "truall" me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 7 860 619.8 (shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetë) lekë.

2. Në pikën 4 shifra "...47 415 (dyzet e shtatë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë..." zëvendësohet me "...7 860 619.8 (shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetë) lekë...".

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 183 000 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës – Kana-lizimeve.

4. Listës së të shpronësuarve në tabelën bashkëlidhur vendimit, i shtohet lista që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME UJËSJELLËS KANALIZIME

Lista e Pasurive që Shpronësohen nga zbatimi i Projektit "Furnizimi me Ujë dhe Shërbimet Sanitare ne Orikum"

Nr	Emër, atësia, mbiemri	Zona/ Kad	Nr. Pasurie	Sip. shpronës.m^2	Lloji i pasurisë	Çmimi lek/m^2	Vlera	Shënime
1	**Bashkëpronësi GJIKOKA**	2832	126/104	580.5	Truall	7044	4089042	Konfirmuar ZVRPP
2	**Bashkëpronësi MEHILLAJ**	2832	2/ 15.	528.7	Truall	7044	3724162.8	Proces.konfirmimi
	SHUMA			**1109.2**			7813204.8	